KQZ
U PROTOKOLLUA
NR. 3744/2 PROT
DATE 13.12.2016

# RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE SHPENZUARA PER VITIN KALENDARIK 2015

-----------------------------------------------------------------------------------------------------------

## RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR PËR QËLLIME TË VEÇANTA PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA PARTIA "POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPERISE"

**NENTOR 2016**

**EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR**
**THEODHORAQ GJOSHA**

ERK AUDITING sh.p.k
K91713008K
IEKA
Tirana - Albania

## Tabela e përmbajtjes

**RAPORTI I VEÇANTË I AUDITIT TË PAVARUR**
**PASQYRA E TË ARDHURAVE (TABELA E FONDEVE TE PERFITUARA NGA PARTIA )**
**PASQYRA E SHPENZIMEVE (DEKLARATE E ARKETIMIT DHE PAGESAVE TE PARTISE)**
**DEKLARATE MBI KONFLIKTIN E INTERESAVE PER FINANCIMIN E SUBJEKTEVE ZGJEDHORE**

**Referencat ligjore:**

Për kryerjen e këtij misioni jemi mbështetur në përputhje me:

- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit me referencë të veçantë SNA 800.
- Ligjin nr.10019.datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"
- Ligjin nr.10091datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar"
- Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- Çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë **"POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPERISE" (PPKSH ) ,me Kryetar Z. PAL SHKAMBI**

# RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR
# PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE SHPENZUARA
# PER VITIN KALENDARIK 2015

---

*Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve*

Une kam audituar pasqyrën (deklaratën) bashkëlidhur të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të **"Partise Popullore Kristiandemokrate e Shqiperise"**

për periudhën viti 2015.

***Pasqyra eshte pergjegjesi e drejtimit te subjektit zgjedhor*** **"Partise Popullore Kristiandemokrate e Shqiperise".**

Kjo pasqyrë (deklarata) është përgatitur nga Partia bazuar në librin e llogarive të Partisë dhe të rregjistrit të posaçëm, miratuar si model me vendimin e KQZ-së, të cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjitha transaksionet në lidhje me fushatën zgjedhore , që kanë dhënë bazën për përgatitjen e pasqyrës së arkëtim – pagesave.

***Përgjegjësia ime*** është të shpreh një opinion mbi këtë pasqyrë bazuar në auditimin tim.

Unë kam kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit në referencë të veçantë me SNA 800 "Konsiderata të vecanta – auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qellime specifike'. Këto standarte kërkojnë që unë të veproj në pajtim me kërkesat e etikës dhe të planifikoj e të kryej auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin që pasqyrat financiare të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për zgjedhjet vendore të mos përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshire vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale, qofte si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve , audituesi merr në konsideratë kontrollin e brëndshem të Partisë në lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare , me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të nevojshme për rrethanat financiare, por jo me qëllimin që të shprehë një opinion për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të partisë.

Auditimi përfshin gjithashtu shqyrtimin mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare, vlerësimin e përshtatshmërise së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi i Partisë si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që unë kam siguruar është e mjaftushme dhe e përshtateshme për të dhënë një bazë per opinionin tim të auditimit.

Detyra e subjektit zgjedhor **"Partise Popullore Kristiandemokrate e Shqiperise"** është të përgatisë pasqyrën bashkëlidhur mbi bazën e arkëtimeve dhe pagesave.

Subjekti deklaron se nuk ka perfituar asnje fond nga buxheti i shtetit dhe nuk ka bere shpenzime.

Për mendimin tim, pasqyra e bashkëlidhur e fondeve të përfituar dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2015, është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën arkëtimeve dhe pagesave konform me ligjin nr. 9228, datë29.04.2004 i ndryshuar 'Për kontabitetin dhe pasqyrat financiare'.

THEODHORAQ GJOSHA

Ekspert Kontabel i Rregjistruar

Telefon 0692054541

ERK AUDITING sh.p.k
K91713008K
IEKA
Tirana - Albania

**Deklarate e arketimit dhe pagesave e Partise "POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPERISE " per vitin 2015**

| Pershkrimi sipas burimit dhe natyres se shpenzimit | Periudha |
|---|---|
| **Burimet(te ardhurat) nga:** | |
| Kuota e antaresise | 30,000 lek |
| Fonde publike nga shteti | lek |
| Dhurime nga persona fizike dhe persona juridike | lek |
| Burime te tjera (donacion nga kryetari) | 230,000 lek |
| **Totali i burimeve** | **260,000 lek** |
| | |
| **Shpenzime(perdorime)** | **lek** |
| Marrje salla me qira | lek |
| Reklama televizive | 30,000 lek |
| Reklama ne radio | lek |
| Shpenzime telefonike | lek |
| Shpenzime per postera, fletevolante, fletepalosje | lek |
| Shpenzime kancelarie | 30,000 lek |
| Shpenzime per karburant | 200,000 lek |
| **Totali i shpenzimeve** | **260,000 lek** |
| **Teprica e burimeve neto** | **0 lek** |

**"PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPERISE"**

**KRYETARI I PARTISE**

**Z. PAL SHKAMBI**

PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPERISE
KRYESIA

TABELA E FONDEVE TË PËRFITUARA NGA PARTIA/KOALICIONI Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë PREJ PERSONAVE FIZIKË OSE JURIDIKË VENDAS, GJATE VITIT 2015

| NR | PËRSHKRIMI I DHURIMIT | VLERA NË LEK | IDENTITETI I PLOTË I DHURUESIT | NIPTI | DATA E DHURIMIT | NR.I LLOGARISË KU U DEPOZITUA DHURATA |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Unë i nënshkruari Av. Pal Shkambi, në cilësinë | | | | | |
| 2 | e Kryetarit të Partisë Popullore Kristiandemokrate e | | | | | |
| 3 | Shqipërisë deklaroj se nuk kam marrë as një fond | | | | | |
| 4 | nga Shteti dhe individët gjatë vitit 2015, për të financuar | | | | | |
| 5 | veprimtarinë e Partisë. | | | | | |
| 6 | Theksoj se nuk kam marrë as një fond kurrë për financim. | | | | | |
| 7 | E lëshoj këtë deklaratë përpara zyrtarit kontrollues | | | | | |
| 8 | Theodhoraq Gjesha | | | | | |
| 9 | Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë | | | | | |
| 11 | | | | | | |
| 12 | | | | | | |
| 13 | | | | | | |

Kryetari i Partisë
Av. Pal Shkambi

**SHUMA TOTALE E DHURUAR**

**Shifër (fjalë) lek**

*Shënim:* Për cdo dhuratë në sende ose shërbime, subjekti zgjedhor do të llogarisë dhe deklarojë kundërvleftën në lekë të sendeve ose shërbimeve duke u bazuar në indeksin mujor të cmimeve, të publikuar nga INSTAT. Për sendet ose shrbimet, vlera e të cilave nuk pasqyrohet në indeksin mujor të cmimeve, subjektet zgjedhore do t'i referohen cmimit të tregut në momentin e marrjes së dhuratës.

**PARTIA/KOALICIONI/KANDIDAT i propozuar nga zgjedhesit** ____________________

Miratuar me vendimin e KQZ-sw nr.266, datw 01.06.2009

PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPERISE • KRYESIA

**Deklaratë**

**Mbi konfliktin e interesave për financimin e subjekteve zgjedhore**

**Të personit juridik vendas ose aksionerit të subjektit juridik për VITIN 2015**

"Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë

| |
|---|
| *Neni 89 i kodit zgjedhor*<br>*Nalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo cdo aksioner i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:* |
| 1.Ka përfituar fonde publike, kontrata pune apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlere mbi 10 milion lekë<br>2.Ushtron veprimtari në fushën e medias<br>3.Ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme<br>4.Ka detyrime monetare ndaj Buxhetit te Shtetit ose ndaj cdo institucioni publik |

Unë i nënshkruari Pal Ukcamli me cilësinë e personit juridik/aksioner i personit juridik____________________, deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të ndalimeve të përcaktuara në nenin 89 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor dhe deklaroj se nuk jam në asnjë nga rrethanat e përcaktuara në dispozitën e mësipërme.

Data e dorëzimit të deklaratës 15-11-2016

**Deklaruesi**

Pal Ukcamli

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPERISE
KRYESIA

LETER E DREJTIMIT

Drejtuar Z. Theodhoraq Gjosha
Ekspert Kontabel i Regjistruar

Tirane me, 15.11.2016

Kjo leter e deklarimeve jepet ne lidhje me kryerjen e auditimit tuaj ligjor te fondeve te perfituara dhe te shpenzimeve te kryera nga Partia "Popullore Kristiandemokrate e Shqiperise" ne vitin 2015, me qellimin e shprehjes se nje opinioni ne se fondet e perfituara dhe te shpenzimet e kryera, japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte.

Ne e njohim pergjegjesine tone per paraqitjen e vertete te regjistrave te posacem dhe te pasqyrave financiare, ne pajtim me Ligjin nr. 10019, date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise", Nenet 87, 88, 89, 90 dhe 91 si dhe menyren e raportimit financiar te tyre.

Ne konfirmojme, sipas njohurise dhe besimit tone me te mire, deklarimet ne vijim:

- Nuk kane egzistuar parregullsi te cilat mund te implikojne Drejtimin ose te punesuarit me nje rol te rendesishem ne kontrollin e brendshem, qe mund te kene nje efekt material ne regjistrat e paraqitur.
- Ne ju kemi vene ne dispozicion te gjitha librat e llogarive dhe dokumentacionin mbeshtetes per fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera gjate fushates zgjedhore.
- Ne konfirmojme plotesine e informacionit te dhene ne lidhje me indentifikimin e paleve te lidhura.
- Regjistrat e posaçem dhe pasqyrat financiare nuk kane anomali materiale, perfshire ketu dhe dokumente te paregjistruara.
- Per administrimin e fondeve eshte vepruar ne perputhje me kerkesat e Ligjit nr. 10019, date 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012
- dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015 " Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise" dhe neneve perkatese te tij. Nuk ekziston asnje papajtueshmeri me kerkesat e autoriteteve rregulluese qe, ne rast papajtueshmerie, mund te kete efekt material ne regjistrat e posaçem dhe pasqyrat financiare.
- Nuk ka ngjarje te mevoneshme tej mbylljes se regjistrave te posaçem dhe pasqyrave financaire, te cilat te kerkojne rregullimin e paraqitjes se tyre.

Kryetari i Partise "Popullore Kristiandemokrate e Shqiperise"

PAL SHKAMBI

PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPERISE
KRYESIA

Financieri

## Klienti: PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPERISE

Plani i punës së auditimit të fondit të vitit kalendarik 2015
të PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPERISE

| Nr | Lloji i sherbimit | Ore Pune Planifikuar | Cmimi per 1 ore | Vlera e sherbimit pa tvsh |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Pune pergatitore per misionin | | | |
| 1.1 | Njohja me ftesen e KQZ për aplikimin në tender. Verifikimi i papajtushmerive ligjore, përgatitja e dokumentacionit dhe kthimi i përgjigjes për fazën e parë të aplikimit | 2 | 3,000 | 6,000 |
| 1.2 | Përgatitja e dokumentave shtesë për fazën e dytë | 2 | 3,000 | 6,000 |
| 1.3 | Lidhja e kontratës me KQZ-në | 2 | 3,000 | 6,000 |
| 1.4 | Hartimi i planit të punës, bazuar në njohjen me legjislacionin për financimin e partive dhe fushatës zgjedhore, si dhe ligjit të OJF-ve | 2 | 3,000 | 6,000 |
| 2 | Kontakte me stafin drejtues dhe administrues të partisë për prezantimin e misionit të auditimit të fushatës | 2 | 3,000 | 6,000 |
| 3 | Njohja e përgjithshme dhe analitike e dokumentacionit ligjor të administrimit | 2 | 3,000 | 6,000 |
| 4 | Verifikimi i fondit të përfituar sipas burimit për fushatën zgjedhore | | | 0 |
| 4.1 | Nga buxheti i shtetit | 0 | | 0 |
| 4.2 | Nga fondet e veta të partisë | 0 | | 0 |
| 4.3 | Nga sponsorizimet në llogari bankare | 0 | | 0 |
| 4.4 | Sponsorizime në materialet publicitare | 0 | | 0 |
| 5 | Verifikimi i shpenzimeve të fushatës sipas destinacionit të kryer për: | | | 0 |
| 5.1 | Marrje salla me qira | 0 | | 0 |
| 5.2 | Reklama televizive | 0 | | 0 |
| 5.3 | Reklama ne radio | 0 | | 0 |
| 5.4 | Shpenzime telefonike | 0 | | 0 |
| 5.5 | Shpenzime për postera, fletëvolante, fletëpalosje | 0 | | 0 |
| 5.6 | Shpenzime kancelarie | 0 | | 0 |
| 5.7 | Shpenzime për karburant | 0 | | 0 |
| 5.8 | Pagesa e firmave konsulente | 0 | | 0 |
| 5.9 | Pagesa për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore | 0 | | 0 |
| 6 | Kontakte dhe verifikime te vecanta sipas nevojës që do të paraqitet | 4 | 3,000 | 12,000 |
| 7 | Sistemim i materialeve të kontrolluara, verifikime të ceshtjeve të nevojshme dhe përgatitja për raportin | 2 | 3,000 | 6,000 |
| 8 | Hartimi i raportit të auditimit sipas SNA-së 800 | 5 | 3,000 | 15,000 |
| 9 | Dorzimi i raportit KQZ | 2 | 3,000 | 6,000 |
| | **Totali i kohës së punës i parashikuar** | **25** | **3,000** | 75,000 |

Për KQZ-në
Sekretar i përgjithshm

Ofruesi i Shërbimit
Eksperte Kontabël e Regjistruar
Theodhoraq Gjosha

ERK AUDITING sh.p.k
K91713008K
IEKA
Tirana - Albania